

## ELIMINIMI

1. "Eliminim" në terminologjinë mjekësore quajmë:
  - a. Largimin e mbetjeve radioaktive nga zonat e kontaminuara
  - b. Asgjësimin e mbetjeve spitalore
  - c. Gjakderdhjen gjate ciklit menstrual
  - d. Largimin fiziologjik të mbetjeve që prodhohen nga trupi gjatë aktivitetit jetësor.
  
2. Urina prodhohet dhe eliminohet nga:
  - a. Filtrimi i gjakut dhe nxjerrja e mbetjeve në formë të lëngëshme nëpërmjet organeve të traktit urinar
  - b. Funkzioni i mekanizmit mbrojtës të organizmit dhe nxjerrja e lëngjeve dhe plazmës së tepërt nëpërmjet uretrës
  - c. Filtrimi i gjakut nga hepari
  - d. Si rezultat i çrregullimit të balancës osmolitike të lëngjeve në organizëm
  
3. Cila është sasia mesatare e urinës ditore që prodhojnë veshkat e njeriut:
  - a. 2 litra
  - b. 1,8 litra
  - c. 1.5 - 2 litër
  - d. 500 ml
  
4. Me anë të cilit procesi jetësor largohet CO<sub>2</sub> nga organizmi:
  - a. Me anë të defekimit
  - b. Me anë të urinimit
  - c. Me anë të djersitjes
  - d. Me anë të frymënxjerrjes
  
5. Feçet janë mbetje të prodhuara nga:
  - a. Sistemi i qarkullimit të gjakut
  - b. Sistemi gastro intestinal
  - c. Sistemi i riprodhimit
  - d. Sistemi i gjendrave egzokrine
  
6. Çfarë ngjyre duhet të ketë urina e eliminuar nga një organizëm pa patologji:
  - a. Ngjyrë portokalli të celët
  - b. Ngjyrë rozë
  - c. Ngjyrë limoni (Citreus)
  - d. Pa ngjyrë (transparente)
  
7. Cila nga gjendjet e mëposhtëme nuk mund të shkaktojë konstipacion:
  - a. Ndërprerja ose ndryshimim i aktivitetit fizik, prania e stresit

- b. Ndryshimi i rutines ose zakoneve ditore ose marrja e medikamenteve
  - c. Zgjatja e kohës së tranzitit të ushqyerjes nga goja deri në anus ose sindromi “zorra dembele”
  - d. Mjekimet për sëmundje të ndryshme, dehidratimi dhe dieta e varfër në fibra
  - e. Moshimi ose mplakja e njeriut.
8. Cila nga gjendjet patologjike të mëposhtëme mund të shkaktojë inkontinence :
- a. Skleroza multiple
  - b. Diabeti
  - c. Sëmundjet Neuro-motore
  - d. Konstipacioni i rëndë
  - e. Asnjëra nga gjendjet me sipër
  - f. Të gjitha më sipër
9. Dieta e pasur me fibra dhe lëngje është shkak për konstipacionin e rëndë:
- a. E vërtetë
  - b. E gabuar
10. Nje pacient nuk ka urinuar që nga koha kur hyri në sallën e operacionit të kryer 8 orë më parë. Cili do të ishte veprimi i parë infermieror për të zgjidhur situatën:
- a. Të njoftojë mjekun për gjendjen e të sëmurit
  - b. Të kateterizojë pacientin menjëherë
  - c. Të vlerësojë pacientin për nivelin e mbushjes së fshikëzës urinare
  - d. T'i rekomandojë pacientit të përkulet dhe të përpiqet të urinojë.
11. Niveli i ulet i estrogjenit tek gratë e moshës së tretë mund të shkaktojë inkontinencë
- a. E vërtetë
  - b. E gabuar
12. Inkontinenca mund të jetë shkak i izolimit dhe tërheqjes nga jeta sociale për shkak të situatave të vështira dhe ndrojtjes që shkakton:
- a. E vërtetë
  - b. E gabuar
13. Çfarë duhet të bëjë infermieri kur i paraqitet një person i moshuar me inkontinencë:
- a. Ta referojë pacientin tek mjeku specialist
  - b. Të veprojë me etike për të ruajtur dinjitetin e pacientit
  - c. Të rekomandojë pirjen e sa më pak lëngjeve
  - d. T'i thotë pacientit që është një gjendje normale për të moshuarit
14. Konstipacioni është një gjendje jo normale e organizmit që shfaqet me:

- a. Defekim të shpeshtë më shumë se 2 herë në ditë
  - b. Mungesë të defekimit për më shumë se 2 ditë
  - c. Defekim në ngjyrë të zezë dhe erë të rëndë të pazakonëshme
  - d. Feçe të pa ngjyrosura ose në ngjyrë të zbardhur si gelqere
15. Cili medikament përdoret në konstipacionin akut dhe jep efekt për 8-12 orë
- a. Laksativë Stimulante
  - b. Laksativë osmolitikë
  - c. Zbutës bimorë të feces ose klizma rektale
  - d. Laksativë me veprim të zgjatur
16. Infermieri duhet të kontrollojë feçet e pacientit për:
- a. Ngjyrën
  - b. Erën
  - c. Konsistencën, sasinë dhe formën
  - d. Frekuencën e jashtëqitjes
  - e. Të gjitha të përmendura më lartë
  - f. Nuk e ka për detyrë
17. A është inkontinenca e urinës dhe jashtëqitja e shpeshtë pjesë e procesit normal të moshimit:
- a. E vërtetë
  - b. E gabuar
18. Tek burrat Inkontinenca Stresante mund të çojë në nevojën e ndërhyrjes kirurgjikale në prostatë:
- a. E vërtetë
  - b. E gabuar
19. Koha normale e kalimit (tranzitit) të ushqimit nga goja deri në anus është:
- a. Më pak se 1 ditë
  - b. Më shumë se 1 ditë
  - c. Më pak se 5 ditë
  - d. Më shumë se 5 ditë
20. Numri i njerëzve që vuajnë nga inkontinenca është e vështirë të matet saktë për shkak të:
- a. Njerëzit janë skeptik për mjekimin ose mendojnë që është një gjendje kalimtare.
  - b. Njerëzit nuk kërkojnë ndihmë për shkak të ndjenjës së ndrojtjes dhe turp
  - c. Numri i njerëzve që vuajnë është shumë i vogël ndaj nuk mbahen statistika
  - d. Nuk konsiderohet si problem i rëndësishëm shëndetësor, pavarësisht incidencës.

21. Për çfarë qëllimi kryhet analiza “Feçe për gjak okult”:
- Për të zbuluar praninë e paraziteve dhe lambliazës në feçe
  - Për të hetuar infeksionet e zorrës së trashë
  - Për të matur nivelin e bacterium *Escherichia Coli*
  - Për të hetuar praninë e elementëve mikroskopikë të gjakut me qëllim diagnostikimin e sëmundjeve të traktit digjektiv.
22. A janë gjendrat egzokrine të djersës një organ i eliminimit të substancave të dëmshme nga trupi:
- E vërtetë
  - E gabuar
23. Diarrrhea mund të shkaktohet nga:
- Infeksionet dhe helmimet ushqimore
  - Grumbullime fekale në zorrë
  - Anomali si Sindromi i zorrës së irrituar
  - Ushqime të yndyrshme, ose Intolerancë nga laktoza
  - Mjekime si psh Antibiotikët ose Laksativët
  - Asnjera nga këto arsye
  - Të gjitha me sipër
24. Cili është organi kryesor me anë të të cilit eliminohen (ekskretohen) gjate tranzitit barnat që e kanë kryer procesin e absorbimit:
- Hepari
  - Truri
  - Trakti urinar, veshkat
  - Pulmonet
  - Trakti gastro intestinal
25. Substancat Medikamentoze të përdorura për trajtimin e sëmundjeve kanë një kohë të ndryshme eliminimi:
- E vërtetë
  - E gabuar
26. Për një pacient me insuficiencë renale dhe që i nënshtrohet Dializës egziston rreziku i:
- Peritonitit
  - Kalkulozes renale
  - Hepatitit serotik
  - Infeksioneve të fshikëzës urinare